

## QEVERIA E KOSOVËS - TENDERËT PËR ENERGJI TË ERËS 150 MW

### INFORMACION PËR ZHVILLUESIT E INTERESUAR

Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës (ME) planifikon të zhvillojë tenderët e parë në vend për gjenerim të energjisë elektrike nga era me një kapacitet total të mbështetur prej rreth 150MW (në të gjitha projektet). Këshilltar kryesor i transaksioneve në QK për strukturimin dhe implementimin e tenderëve është emëruar IFC. Poashtu zhvillimi i projekteve është mbështetur edhe nga Aktiviteti i USAID-it për Qëndrueshmërinë e Energjisë në Kosovë (ESA).

Projektet do të implementohen në dy tenderë të njëpasnjëshëm me një kapacitet të mbështetur prej rreth 75-100MW për secilin prej tyre. Vendndodhja për të dy tenderët nuk është e përcaktuar.

Secili tender do të përbëhet nga dy faza – Kërkesa për Kualifikime (KpK) dhe Kërkesa për Propozime (KpP).

KpK për tenderin e parë pritet të publikohet në tremujorin e tretë të vitit 2024. Ofertuesit e parakualifikuar do të ftohen të dorëzojnë propozimet në fillim të vitit 2025.

KpK dhe KpP për tenderin e dytë (për kapacitetin e mbetur) pritet të shpallen në vitin 2025.

ME ka për qëllim të përdorë fondet nga Instrumenti i Reziliencës dhe Qëndrueshmërisë (RSF) të Fondit Monetar Ndërkombëtar (IMF) për të ndihmuar në zhvillimin e 150 MW kapaciteteve të energjisë së erës. ME do të përdorë fondet e RSF-së për të bashkëinvestuar në projektet e energjisë së erës së dhënë sipas një skeme të Partneritetit Publiko-Privat (PPP), duke synuar të reduktojë rrezikun për investitorët privatë. Projekteve të suksesshme do të shpërblehet me një Marrëveshje afatgjatë për Blerjen e Energjisë (PPA) të rregulluar fizikisht.

ME synon që projektet të respektojnë standardet ndërkombëtare të mjedisit dhe pjesës sociale, siç janë Standardet e Performancës të IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale. Si rezultat, parashikohet që projektet të hartohen, ndërtohen, instalohen, operohen, mirëmbahen dhe çmontohen në përputhje me ligjet kombëtare në fuqi për çështjet mjedisore, të sigurisë, të punës, ato sociale dhe të sigurisë dhe praktikave të mira të industrisë ndërkombëtare.

Seksionet e mëposhtme përshkruajnë kërkesat kryesore për pjesëmarrje në proces që pritet të plotësojnë zhvilluesit e interesuar **në fazën e KpK-së**.

Mund të kërkohet informacion shtesë në fazën e KpP-së.

Për të shmangur dyshimet, ky njoftim është vetëm për qëllime informative. Synohet t'u sigurojë ofertuesve të mundshëm informacionin përkatës mbi kërkesat e parashikuara, në mënyrë që ata të mund të ndërmarrin hapat e duhur për të përgatitur dokumentacionin e tyre për procesin e planifikuar. Megjithatë, përmbajtja e paraqitur në këtë dokument mund të ndryshojë. Kërkesat e listuara janë jo shteruese, mund të rishikohen dhe mund të futen kritere shtesë gjatë fillimit zyrtar të procesit (eve) të tenderimit. ME rezervon të drejtën për të ndryshuar, rishikuar ose ristrukturuar ndonjë nga këto kritere në dokumentacionin aktual të tenderit që do të publikohet së shpejti.

## **I. KËRKESAT QË LIDHEN ME FIZIBILITETIN E PROJEKTIT**

### **A. DOKUMENTACIONI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIMIT TEKNIK**

**INFORMACIONI I PARAQITUR NË SEKSIONIN A. DO TË JETË VETËM PËR QËLLIME INFORMUESE. AI NUK DO TË PËRDORËT PËR VLERËSIMIN E APLIKACIONEVE PËR PARAKUALIFIKIM.**

1. Përshkrimi i parkut të erës dhe koordinatat, duke përfshirë nënstationin e planifikuar të lidhjes me rrjetin, linjën e transmisionit, pikën e ndërlidhjes dhe rrugët hyrëse.
2. Paraqitja e propozuar e lokacionit dhe distancat ndërmjet turbinave së bashku me kompasin e erës dhe kurbën e densitetit të fuqisë.
3. Nëse është në dispozicion, skema një polare që përfshin:
  - a. Komponentët e nënstationit elektrik të tensionit të lartë (TL): Kabllot e tensionit të mesëm (TM), transformatorët TM/TL, kthinat e TM dhe TL, kabllot e TM mes turbinavekabllot e TL (nëse ka).
  - b. Specifikacionet teknike të Kablllove dhe stabilimenteve elektrike

### **B. RAPORTI I VLERËSIMIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË**

**INFORMACIONI I KËRKUAR NË SEKSIONIN B. DO TË PËRDORËT PËR VLERËSIMIN E APLIKACIONEVE PËR PARAKUALIFIKIM.**

Zhvilluesve të interesuar do t'u kërkohet të paraqesin një raport të vlerësimit të prodhimit të energjisë, i cili duhet të kryhet nga një konsulent i pavarur dhe i kualifikuar për energji të erës.

Raporti duhet të jetë në përputhje me kërkesat nga B.1 deri në B.3 dhe duhet të dokumentojë llogaritjet e parashikimit të prodhimit të energjisë për çdo vit të një periudhe njëzet (20) vjeçare.

#### **B. 1 FUSHATA MATËSE**

1. Kohëzgjatja minimale prej një (1) viti (12 muaj), duke përfshirë një sezon të tërë dimëror (nëntor deri në mars).
2. Të dhënat e matjes së erës të mos jenë më të vjetra se pesë (5) vjet në kohën e afatit të dorëzimit të KPK.
3. Të përdorën pajisje të përshtatshme matëse (p.sh., shtylla meteorologjike si të pavarura, shtylla meteorologjike në kombinim me LiDAR ose SoDAR). “Pajisje të përshtatshme” nënkupton pajisjet matëse të certifikuara nga një konsulent i kualifikuar energjisë së erës (shih seksionin B.2).
4. Të gjitha të dhënat e sensorëve (siq janë, shpejtësia e erës, të dhënat e drejtimit, presioni, temperatura, lagështia) regjistrohen dhe shënohen me kohë në intervale që nuk tejkalojnë 10 minuta. Të dhënat e papërpunuara arkivohen dhe ruhen, dhe ekziston një gjurmë auditimi për korrigjimet e të dhënave në mënyrë që të dhënat të mund të verifikohen në mënyrë të pavarur.
5. Vlerësimi i Prodhimit Vjetor të Energjisë (PVE) do të marrë parasysh aspektet e mëposhtme:
  - i. PVE duhet të bazohet në një model linear të rrjedhjes së erës për një terren të thjeshtë ose një model të dinamikës lëngjeve kompjuterike (CFD) për terren kompleks, varësisht nga tereni i projektit.

- ii. Korrigjimi afatgjatë i PVE-së duhet të llogaritet saktë për të kalkuluar ndryshueshmërinë vjetore të klimës së erës.
- iii. Humbjet dhe pasiguria për vendndodhjen specifike duhet të vlerësohen në raportin që ofron probabilitetin e mëposhtëm të vlerave të tejkalimit: P50, P75, P90, P95, P99.
- iv. Shpejtësia e erës ekstreme duhet të llogaritet për të zgjedhur një klasë turbinash të përshtatshme për vendndodhjen.

## **B. 2 CERTIFIKATA E LËSHUAR NGA KONSULENTI I KUALIFIKUAR I ENERGJISË SË ERËS**

Certifikata kërkohet për të vlerësuar cilësinë e fushatës së matjes së erës dhe rezultatet e studimit të mikro-pozicionimit për projektet e propozuara. Konsulenti i kualifikuar i energjisë së erës nuk mund të jetë as ofertues as pjesë e konsorciumit të ofertuesit dhe duhet të jetë anëtar i një prej shoqatave të mëposhtme të energjisë së erës ose subjekteve të pavarura certifikuese:

- i. Measnet: Rrjeti Ndërkombëtar për Matjet e Harmonizuara dhe të Njohura në Energjinë e Erës
- ii. Këshilli Global i Energjisë së Erës
- iii. TÜV SÜD
- iv. Shoqata Botërore e Energjisë së Erës

Konsulenti i kualifikuar i energjisë së erës duhet gjithashtu të demonstrojë se përmbush kërkesat minimale të mëposhtme të përvojës së deritanishme - të ketë punuar në fushatën e matjes së erës, mikro-pozicionimin dhe vlerësimin e prodhimit të energjisë për të paktën 1 GW të kapacitetit të instaluar të energjisë erës.

## **B. 3. RAPORTI I MIKRO-POZICIONIMIT**

Bazuar në rezultatet e fushatës së matjes së erës dhe orografisë së zonës, do të krijohet një plan ideor i gjeneratorit të turbinës me erë (WTG) dhe mikro-pozicionimi duhet të krijohet duke përdorur softuer profesional të mikro-pozicionimit (p.sh. windPRO, WASP, Windfarmer).

Ky lloj softueri duhet:

1. Të operojë duke lidhur karakteristikat e erës për vendin specifik (shpejtësia, drejtimi, turbulencat) me orografinë e terrenit dhe të lejojë vlerësimin e prodhimit të energjisë elektrike për pozicionime të ndryshme të WTG-së duke përfshirë hyrjet manuale nga zhvilluesi, si madhësia e ndryshme e WTG-së, kurba e fuqisë dhe prodhuesit e ndryshëm.
2. Të marrë parasysh distancën e duhur ndërmjet gjeneratorëve të erës sipas udhëzimeve të aplikueshme të projektimit IEC 61400.

## **C. STUDIMET BAZË TË SHPENDËVE DHE LAKURIQËVE TË NATËS**

### **INFORMACIONI I KËRKUAR NË SEKSIONIN C. DO TË PËRDORET PËR VLERËSIMIN E APLIKACIONEVE PËR PARAKUALIFIKIM.**

Zhvilluesit e interesuar do të duhet të demonstrojnë se kanë angazhuar konsulentë të specializuar të biodiversitetit për të kryer studime bazë për shpendët dhe lakuriqët e natës. Studimet për shpendët dhe lakuriqët e natës duhet të mbulojnë një periudhë minimale prej 12 muajsh deri në kohën kur Projekti të arrijë mbylljen komerciale.

Për shpendët, metodat bazë të mbledhjes së të dhënave do të ndryshojnë në bazë të taksonomisë, por minimalisht duhet të synojnë të identifikojnë gjendjen e shpendëve dhe aktivitetin e fluturimit, duke përfshirë aktivitetin e migrimit dhe rrugët ditore të lëvizjes/ushqyerjes për speciet e identifikuar. Studimet duhet të përfshijnë gjithashtu habitat të përshtatshëm për mbarështimin/pushimin e grabitqarëve/shkabave pranë vendit të projektit për të vlerësuar gjasat e fluturimeve ditore të kërkimit të ushqimit nëpër zonën e Projektit.

Për lakuriqët e natës, studimet bazë duhet të përfshijnë ecjet në terren për të identifikuar zonat brenda vendndodhjes që mund të përdoren nga lakuriqët e natës; monitorimin akustik me ultratinguj pasiv gjatë gjithë vitit, duke përfshirë të paktën dy stacione regjistrimi pasive me mikrofonë të vendosur brenda lartësive që kalojnë rotorët; studimet potenciale dhe të njohura për strehime në vendndodhje dhe rreth vendndodhjes së projektit të energjisë së erës (WPP) për të identifikuar strehimet, dhe (nëse është e mundur) drejtimin e përgjithshëm të fluturimeve të daljes dhe kthimit; dhe studimet transektike akustike me pajisje dore (detektorët e lakuriqëve) në vende të zgjedhura strategjikisht ku aktiviteti i lakuriqëve mund të jetë i përqendruar.

Të gjitha metodat duhet të jenë në përputhje me praktikën e mira të industrisë për WPP.

#### **D. INFORMACIONET TJERA NË LIDHJE ME PROJEKTIN**

**INFORMACIONI I KËRKUAR NË SEKSIONIN D. DO TË JETË VETËM PËR QËLLIME INFORMATIVE, AI NUK DO TË PËRDORET SI KRITER VLERËSIMI NË FAZËN E KPK-SË.**

##### **D. 1 LIDHJA E PLANIFIKUAR ME RRJETIN**

Zhvilluesve të interesuar do t'u kërkohet të përshkruajnë planet e tyre për kycje në rrjet.

##### **D. 2 STUDIMET RELEVANTE MJEDISORE DHE SOCIALE**

Zhvilluesve të interesuar do t'u kërkohet të dorëzojnë studimet mjedisore dhe sociale (M&S) të plotësuara ose të siguruara tashmë për projektin e propozuar.

Për studimet që ende nuk janë të përfunduara në kohën e dorëzimit të kërkesës për ofertë (KpK), zhvilluesit e interesuar do të paraqesin fushëveprimin e punës dhe do të tregojnë statusin e avancimit të tyre. Shembuj të studimeve potencialisht relevante janë renditur më poshtë. Është e njohur se të gjitha mund të mos jenë domosdoshmërisht të zbatueshme për secilin projekt. Në rastin kur këto studime nuk janë siguruar, zhvilluesit e interesuar duhet të japin një arsytim të shkurtër për të shpjeguar pse ato nuk janë relevante.

- VNMS/VNM i kompletuar për qëllime të miratimit mjedisor nga autoriteti rregullator kombëtar.
- Analiza e alternativave të përzgjedhjes së vendndodhjes, duke përfshirë infrastrukturën ndihmëse si linja e transmisionit dhe rrugët hyrëse, që është në përputhje me hierarkinë e zvogëlimit të rreziqeve.
- Harta e kufizimeve M&S që identifikon kufizime të rëndësishme M&S të cilat mund të rrisin rrezikun M&S të lokacionit dhe/ose kërkojnë masa të konsiderueshme zbutëse. Ajo duhet të përfshijë të dhëna hapësinore të gjeo-referencuara për kufizimet e identifikuar mjedisore, të biodiversiteti dhe sociale (ose faktorë të tjerë me rrezik të lartë).

- Qasja ndaj përvetësimit të të drejtave të tokës, duke përfshirë parimet dhe procedurat e përgjithshme për të siguruar të drejtat e përdorimit të tokës dhe për të pasqyruar ndikimet që lidhën me anen sociale në marrëveshjet e qirasë ose për të ofruar kompensim adekuat, duke përfshirë zhvendosjen dhe mbështetjen për rikthimin në gjendjen e mëparshme, nëse është e nevojshme. Qasja gjithashtu duhet të përmbledhë vlerësimin e pronësisë së tokës dhe ndikimet dhe rreziqet e mundshme negative nga projekti, dhe statusin e të drejtave të tokës/negociatat për tokën.
- Modelimi i zhurmës.
- Modelimi i hijes.
- Ekzaminimi kritik i habitatit që identifikon të gjitha vlerat e biodiversitetit të lidhura me zonën e ndikimit të Projektit që kanë potencialin për t'u kualifikuar si habitat kritik sipas Standardit të Performancës 6 të IFC-së dhe Shënimit 6 në Udhëzues.
- Strategjia e reduktimit të kafsheve të egra
- Qasja e kujdesit të duhur për rrezikun e punës së detyruar në zinxhirin e furnizimit

### **D. 3 VLERËSIMI I NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL (VNMS) TERMAT E REFERENCËS (TOR)**

Zhvilluesit e interesuar duhet të paraqesin Termat e Referencës për VNMS-në e Projektit që përputhet me Standardet e Performancës së IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale.

### **D. 4 KORNIZA E ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT**

Zhvilluesit e interesuar duhet të paraqesin kornizën e tyre të angazhimit të palëve të interesit, duke përfshirë angazhimin me komunitetet e prekura për rreziqet e ndërlidhura me aspektin social dhe me organizatat kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për rrezikun e ndërlidhur me biodiversitetin.

## **II. KËRKESAT LIDHUR ME PËRVOJËN DHE KAPACITETIN E OFERTUESIT**

Zhvilluesit e interesuar, të referuar këtu si Ofertues, duhet të demonstrojnë përshtatshmërinë e tyre vetë (ose nëpërmjet kompanive të tyre amë) ose duke krijuar konsorciume me palë të tjera të kualifikuara.

### **A. PËRVOJA NË ZHVILLIMIN DHE OPERIMIN E PROJEKTEVE TË BRE-VE TË LIDHURA NË RRJET**

1. Ofertuesit (vetëm ose përmes një konsorciumi) duhet të demonstrojnë përvojë në zhvillimin dhe operimin e projekteve të BRE-ve të lidhura në rrjet me kapacitet kumulativ prej 60 MW, ku të paktën 40 MW duhet të jenë kapacitete të gjeneruara nga era, duke përfshirë të paktën një projekt të energjisë së erës me një kapacitet energjie më shumë se 20 MW.
2. Në lidhje me projektin e erës të përdorur si dëshmi nën pikën II. A. 1 më sipër, Ofertuesit duhet të ofrojnë dëshmi të menaxhimit të angazhimit të palëve të interesit në komunitet dhe/ose çështjeve të tokës që lidhen me përvetësimin e të drejtave të tokës, konsultimin me palët e interesit nga komuniteti dhe kompensimin për pronarët dhe përdoruesit e tokës. Dëshmitë mund të përfshijnë, por nuk kufizohen domosdoshmërisht në: Planin e Veprimit për Zhvendosje, Planin e Rivendosjes së Jetesës, Kornizën e Kompensimit dhe Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit.
3. Çdo impiant i përdorur si dëshmi duhet të ketë arritur datën e operimit komercial në (10) vitet e fundit para datës së shpalljes të KpK-së
4. Çdo impiant i përdorur si dëshmi duhet të ketë qenë funksional për të paktën një (1) para datës së shpalljes së KpK-së.

### **B. KAPACITETI FINANCIAR**

Ofertuesit (vetëm ose nëpërmjet një konsorciumi) duhet të demonstrojnë:

1. Vlera neto (e llogaritur si aktivet minus pasivet ) prej të paktën 30,000,000 Euro në secilin nga tri (3) vitet e fundit kalendarike para datës së shpalljes së KpK-së
2. Qarkullimi vjetor prej të paktën 25,000,000 Euro në secilin nga tri (3) vitet e fundit kalendarike para datës së publikimit të KPK.

## Mosmarrja e përgjegjesisë:

- Ky dokument është përgatitur nga ME në emër të QK-së për t'u ofruar palëve të interesuara informacion mbi tenderët e ardhshëm për projektet e energjisë së erës të lidhur me rrjetin me kapaciteti të mbështetur prej 150 MW ("Projektet").
- Informacioni i dhënë në këtë dokument është paraqitur vetëm për qëllime informative. Ky dokument nuk përbën dhe as nuk synon të përbëjë ose krijojë një ofertë të vlefshme për të pranuar ose kërkuar një ofertë për të investuar ose për të marrë pjesë në projekte. Informacioni i dhënë në këtë dokument synon t'u sigurojë ofertuesve të mundshëm informacionin përkatës mbi kërkesat e parashikuara, në mënyrë që ata të mund të ndërmarrin hapat e duhur për të përgatitur dokumentacionin e tyre për tenderët e planifikuar. Kërkesat e listuara nuk janë shteruese, mund të rishikohen dhe mund të futen kritere shtesë gjatë fillimit zyrtar të tenderit(eve) kur të publikohet dokumentacioni përfundimtar i tenderit. Është thelbësore të theksohet se pajtueshmëria me çdo kriter të mundshëm të përshkruar në këtë dokument nuk e kualifikon automatikisht një subjekt për pjesëmarrje në tenderin për energji të erës. Kualifikimi zyrtar varet nga plotësimi i të gjitha kërkesave të përcaktuara që mund të ndryshohen kur publikohet dokumentacioni zyrtar i tenderit dhe duke përfshirë ato të paraqitura më pas në dokumentacionin e tenderit. Për shmangien e dyshimit, ME rezervon të drejta të pakufizuara dhe të pakushtëzuara për të ndryshuar, rishikuar ose ristrukturuar ndonjë nga këto kritere siç e sheh të përshtatshme në dokumentacionin përfundimtar të tenderit që do të publikohet së shpejti. Për të shmangur dyshimin, informacioni i paraqitur në këtë dokument nuk do të konsiderohet se krijon ndonjë të drejtë ligjore për ofertuesit e mundshëm për të kërkuar nga ME ose autoritetet tjera që të mos bëjnë ndonjë ndryshim, rishikim ose plotësim të mëtejshëm të kërkesave në dokumentacionin përfundimtar të tenderit.
- Ky dokument nuk synon të ofrojë informacion të plotë rreth Projekteve. Asnjë përfaqësim apo garanci, e shprehur apo e nënkuptuar, nuk është bërë, apo nuk pranohet ose do të pranohet ndonjë përgjegjësi e çfarëdo lloji nga QK, ME apo IFC, përfshirë në lidhje me saktësinë, plotësinë apo vërtetësinë e informacionit që përmban ky dokument.
- Ky dokument nuk duhet të interpretohet se ofron ndonjë këshillë financiare, kontabël, ligjore, rregullatore ose tatimore. Ky dokument dhe çdo gjë që ai përmban nuk krijon ndonjë marrëdhënie ligjore detyruese ose detyrë apo detyrim tjetër të zbatueshëm me ligj nga çdo marrës i këtij dokumenti sipas, ose në lidhje me, objektin e tij në lidhje me QK, ME ose IFC. As QK, ME dhe as IFC nuk merr asnjë përgjegjësi ligjore (përfshirë çdo përgjegjësi për kujdes) ndaj marrësve të këtij dokumenti, dhe asnjëri prej tyre nuk do të ketë ndonjë përgjegjësi çfarëdo qoftë (për neglizhencë ose forma tjera të ngjashme) për këtë dokument ose për çdo komunikim tjetër me shkrim ose me gojë të transmetuar te marrësi gjatë vlerësimit të Projekteve. As QK, ME dhe as IFC nuk do të jenë përgjegjës të rimbursojnë ose kompensojnë ndonjë investitor të mundshëm dhe marrës tjetër të këtij dokumenti për ndonjë humbje, kosto ose shpenzim të shkaktuar (qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi) nga ndonjë investitor i mundshëm dhe marrës tjetër i këtij dokumenti gjatë vlerësimit apo veprimit sipas përmbajtjes së tij ose në ndonjë mënyrë tjetër në lidhje me Projektet ose në ndonjë transaksion, qoftë të përfunduar ose jo, që mund të pasojë.
- Ky dokument ofron një pasqyrë të kërkesave të parashikuara për ofertuesit për të marrë pjesë në projekte. Megjithatë, nuk synohet që ai të shërbejë si bazë për ndonjë vendim për investim në projekte, dhe çdo ofertues i mundshëm pritët të bëjë një hetim të tillë të pavarur dhe të marrë këshilla të tilla të pavarura që ai ose ajo mund t'i konsiderojë të nevojshme për vendime të tilla. Për më tepër, ky dokument përmban informacion që për nga natyra e tij është selektiv dhe tregues dhe i cili ishte i disponueshëm që nga 2 korrik 2024. Një informacion i

tillë është i natyrës paraprake dhe mund të përfshijë elemente të rëndësishme të gjykimit dhe analizës subjektive, të cilat mund të jenë ose jo të sakta. Në veçanti, ky dokument nuk përmban ose pretendon të përmbajë të gjithë informacionin që ndonjë marrës i këtij dokumenti mund të dëshirojë për qëllimin e vlerësimit të projekteve. As QK, ME dhe as IFC nuk pranon asnjë përgjegjësi për ta njoftuar ndonjë ofertues të mundshëm, person ose subjekt tjetër nëse ndonjë informacion ose e dhënë e përcaktuar në këtë dokument ndryshon ose rezulton të jetë e pasaktë ose e paplotë, as ta përditësojë, ndryshojë, modifikojë ose rishikojë këtë dokument për të pasqyruar çdo ndryshim, zhvillim, ngjarje, rrethanë, pasaktësi ose paplotësi. Informacioni dhe opinionet e përfshira në këtë dokument janë dhënë në datën e këtij prezantimi dhe janë subjekt ndryshimi pa njoftim, nuk mund të përmbajnë të gjithë informacionet materiale në lidhje me projektet dhe nuk janë verifikuar, miratuar ose vërtetuar në mënyrë të pavarur.

- Ky dokument mund të përfshijë disa deklaratë, besime ose opinione largpamëse në lidhje me projektet. Deklarata të tilla, të cilat përmbajnë fjalët “parashikon”, “beson”, “ka për qëllim”, “vlerëson”, “pret” dhe fjalë me kuptim të ngjashëm, pasqyrojnë besimet dhe pritshmëritë individuale dhe përfshijnë rrezik dhe pasiguri, sepse ato lidhen me ngjarjet dhe varen nga rrethanat që do të ndodhin në të ardhmen. Nuk është bërë asnjë përfaqësim se ndonjë nga këto deklaratë ose parashikime do të realizohet ose se ndonjë rezultat i parashikuar do të arrihet. Ka shumë faktorë që mund të bëjnë që rezultatet dhe zhvillimet aktuale të ndryshojnë materialisht nga ato të shprehura ose të nënkuptuara nga këto deklaratë dhe parashikime. Asnjë deklaratë në këtë prezantim nuk synon të jetë një parashikim për fitim. Si rezultat, ju këshillojmë që të mos keni mbështetje të panevojshme në deklaratë të tilla largpamëse.
- IFC pohon të gjitha privilegjet, imunitetet dhe përjashtimet e saj të garantuara në Nenet e Marrëveshjes së IFC-së, konventat ndërkombëtare dhe çdo ligj të zbatueshëm.